



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

Nr. 701/ prot.
110

Tiranë, më 10.10.2025

VENDIM

Nr. 1218 , Datë 10.10.2025

“PËR NJË KORRIGJIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURENCËS NR.1211, DATË 11.09.2025, “MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. NGA SHOQËRITË EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. DHE ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A.”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Ledia Matja	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.10. 2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Mbi një korrigjim të një gabimi material në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.1211, datë 11.09.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. nga shoqëritë EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. dhe ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA’ DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A.”.

Baza Ligjore: Neni 24, germa d i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe neni 112 i ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pasi shqyrtoi relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi një korrigjim të një gabimi material në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.1211, datë 11.09.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. nga shoqëritë EURIZON

CAPITAL REAL ASSET SOCIETA' DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. dhe ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA' DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A.”,

VËREN SE :

Komisionit të Konkurrencës me Vendimin nr.1211, datë 11.09.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. nga shoqëritë EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA' DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. dhe ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA' DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A.”, autorizoi transaksionin e njoftuar.

Me shkresën nr. 701/8 prot., i AK datë 01.10.2025 “Kërkesë për korrigjim Vendimi”, Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar, nga pala njoftuese, në lidhje me një gabim material të shprehur në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.1211, datë 11.09.2025.

Pala njoftuese ka deklaruar se në Formularin e thjeshtuar të njoftimit të përqendrimit të hartuar prej tyre, ka pasur një pasaktësi në lidhje me cilësimin e njërës prej palëve pjesëmarrëse në përqendrim, konkretisht: *“Eurizon Capital nga ana tjetër është në pronësi të plotë (dhe për këtë arsye e kontrolluar ekskluzivisht) nga ISP, një shoqëri italiane me kod tatimor 00799960158 dhe seli të regjistruar në Torino, Piazza San Carlo 156 – 10121, dhe kompani holding e Intesa Sanpaolo Group”*, paragraf i cili është pasqyruar në pjesën arsyetuese të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës.

Pala njoftuese sqaron se ky paragraf është relatuar i pasaktë në Formular, përse i përket cilësimit të njërës prej palëve pjesëmarrëse në përqendrim, dhe ka kërkuar korrigjimin e këtij paragrafi duke cilësuar se: *Eurizon është një nga shoqëritë pjesë e Grupit Intesa Sanpaolo dhe jo shoqëri holding e Grupit Intesa Sanpaolo, që në fakt është ISP.*

Në nenin 112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përcaktohet se:

1. *Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
2. *Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.*

Komisioni i Konkurrencës gjykon se ky gabim material nuk cenon thelbin e aktit administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe nenit 112 të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

- I. Në faqen nr. 2 të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.1211, datë 11 .09.2025, “Mbi autorizimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të

shoqërisë TECHBAU GREEN ENERGY S.R.L. nga shoqëritë EURIZON CAPITAL REAL ASSET SOCIETA' DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A. dhe ERSEL ASSET MANAGEMENT SOCIETA' DI GESTIONE DEL RISPARMIO S.P.A.", paragrafi i katërt i pikës I. "Palët në transaksion dhe procedura": "EURIZON CAPITAL SGR S.P.A. është shoqëri e krijuar sipas legjislacionit Italian, e regjistruar në Torino dhe shoqëria holding e Intesa Sanpaolo Group", të korrigjohet dhe të zëvendësohet me paragrafin "EURIZON CAPITAL SGR S.P.A. është shoqëri e krijuar sipas legjislacionit Italian, e regjistruar në Torino dhe pjesë e Grupit Intesa Sanpaolo."

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Leida MATJA

()
Zv/Kryetar

Rezana KONOMI

()
Anëtar

Durim KRAJA

()
Anëtar

Denar BIBA

()
Kryetar

